



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI I SHQIPËRISË
KRYETARI**

Tiranë, më 20 tetor 2019.

Shkëlqesisë Së Tij Zotit Talat Xhaferi

Kryetar i Parlamentit

Shkëlqesia Juaj, Z. Kryetar,

I dashur Talat,

Më gëzim të madh marrëm lajmin e shumëpritur se Parlamenti votoi ndryshimin e emrit të Maqedonisë, ashtu siç rekomandoi shumica e votuesve në referendumin e 30 shtatorit.

Kjo është një fitore e madhe për Maqedoninë europiane si edhe për shqiptarët që jetojnë në këtë shtet, i cili po hedh hapa të matur e të qëndrueshëm drejt prosperitetit dhe stabilitetit në rajon e më gjerë.

Jam i bindur se Maqedonia e Veriut, emri me të cilin u pagëzua sot shteti ynë fqinj, mik dhe partner, do të hedhë hapa të tjerë vendimtarë e të sigurt drejt të ardhmes së saj të sigurtë në familjen europiane.

Në këtë fitore të bukur është, padyshim, edhe kontributi i lidërshiptit Tuaj që me largapamësi e mirëkuptim e udhëhoqët Parlamentin drejt kësaj vendim-marrjeje historike, të duartrokatur, jo vetëm nga ne, shqiptarët dhe institucionet e Shqipërisë, por nga të gjithë partnerët tanë strategjikë ndërkombëtarë.

Është gjithashtu edhe kontributi i partive politike shqiptare, deputetët e të cilave votuan të gjithë pro këtij vendimi vizionar.

Përgëzimet e mia të sinqerta, i dashur Talat, për këtë ngjarje të madhe për Maqedoninë e Veriut dhe për të gjithë rajonin.

Sinqerisht,

GRAMOZ RUÇI